



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË



Nr. Regj. 61002-00089-41-2016 (25 Regj)
Date regjistrimi 22.01.2016

Nr.Vendimi 41-2016-302 (25 Regj)
Date vendimi 23.01.2016

V E N D I M

Per marrjen e mases tesekuestroskonservative

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce, e perbere prej:

Gjyqtare Luljeta KOLE

Asistuar nga sekretare Hajrie Rusi, ne Korce me date 23.01.2016 ora 12.15, shqyrtoi ne seance gjyqesore ceshtjen penale qe i perket:

KËRKUES: Prokuroeria prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce, perfaqesuar nga prokurore Dhorina Theodhori.

OBJEKTI: Caktim mase sigurimi pasuror "sekuyster preventive"

Baza ligjore: Neni 274 i K.Pr.Penale.

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te perfaqesueses te Prokurorise prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce, gjykata pasi degjoi:

Prokuroren qe kerkoi pranimin e kerkeses dhe caktimin e mases se sigurimit pasuror "sekuyster preventive" ndaj llogarise bankare te shtetases Entela Hysen Shaholli tek Raiffeisen Bank,

Si dhe pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi ceshtjen ne teresi

V Ë R E N

Ne date 22.01.2016 ora 10.00 nga ana e Prokurorise prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce, eshte paraqitur prane kesaj gjykate kerkesa per caktimin e mases se sigurimit pasuror "sekuyster prebentive" ndaj llogarise bankare te shtetases Entela Hysen Shaholli tek Raiffeisen Bank, bazuar ne nenin 274 te K.Pr.Penale.

Ne baze te neneve 278 dhe 271/1 te K.Pr.Penale, shqyrtimi i kesaj kerkese ne fazen e hetimeve paraprake hyn ne kompetencen lendore dhe tokesore te kesaj gjykate, pasi eshte

gjykata ku mendohen te jene kryer veprimet qe dyshohen se perbejne veper penale, njeheras ku ka nendbanimin personi ndaj depozites bankate te se cilit kerkohet te vendoset sekuster.

Nga faktet dhe provat e paraqitura ne seance gjyqesore, rezultoi se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë janë dërguar materialet hetimore me shkresën me nr. 147 prot, datë 20.01.2016 për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga aktet e administruara në dosjen hetimore rezulton se nga ana e strukturave policore te Sektorit per Krimin Ekonomik e Financar ne Drejtorine Vendore te Policise Korce, jane administruar te dhena, per shtetasen Entela Hysen Shaholli, e datëlindjes 07.09.1987, banuese ne fshatin Voskop-Korçe, e cila më datë 21.12.2015 ka depozituar pranë Raiffeisen Bank shumën 15.000 Euro, duke deklaruar se është e papunë dhe fondet janë "kursime familjare".

Në vijim të kryerjes së veprimeve verifikuese ka rezultuar se:

Më datë 18.01.2016, shtetasja Entela Shaholli ka kërkuar të kryejë një transfertë në vlerën prej 14.000 euro në favor të shtetasit nga Libani, Romeo Ilias në Beirut, Liban. Ajo ka deklaruar se: "Romeo Elias është me profesion ushtarak dhe se është i dashuri i saj, të cilin e ka njohur nëpërmjet rrjeteve sociale "facebook". Qëllimi i dërgimit të fondeve sipas saj është për "arsye shëndetësore" e njëkohësisht ka dërguar nëpërmjet e mailit të saj edhe dokumentin e identifikimit të shtetasit Libanez me detaje (foto).

Nga verifikimi në lidhje me shtetasen Entela Shaholli dhe familjarët e saj, shtetasit Hysen Hamdi Shaholli, i dtl 27.11.1950, Nasibe Sheme Shaholli e datëlindjes 03.01.1955 dhe Alban Hysen Shaholli i datëlindjes 14.06.1981, ka rezultuar se ka transaksione të vlerave vetëm në emër të vëllait të saj, shtetasit Alban Shaholli, si vijon:

-Më datë 04.01.2013, ka kryer depozitime cash pranë Alpha Bank në vlerat 14.000 Euro dhe 10.000 Euro.

-Më datë 22.01.2013, ka tërhequr nga llogaria pranë Alpha Bank shumën 8.000 Euro.

-Në datat 30.04.2013 dhe 12.09.2013, ka tërhequr nga llogaria pranë Alpha Bank përkatësisht shumat 1.700.000 Lekë dhe 11.900 Euro.

Nga verifikimet e kryera ne kartoteken e policise kriminale të Drejtorise Vendore te Policise Korçe, ka rezultuar se shtetasi Alban Shaholli, i dtl. 14.06.1981, ne dt. 18.03.2014, eshte regjistruar si person me precedent kriminalë per veprën penale te trafikimit te narkotikeve. Sipas informacioneve te mara per shtetasin Alban Shaholli, ka rezultuar se ky shtetas ne dt.10.12.2013, eshte arestuar ne shtetin Grek, me lende narkotike.

Nga verifikimi për biznes të regjistruara (QKR) në emër të shtetasve të mësipërm rezulton se shtetasit Hysen Shaholli është ortak themelues në shoqërinë "Shaholli Energy" shpk me NIPT K74102014I, themeluar në Korçë më datë 02.05.2007 e me objekt të veprimtarisë "Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha mallrave industriale, ekonomike, bujqësore, metale, duralumin. Projektim, ndërtim dhe shfrytëzim të hidrocentraleve dhe të termoçentrale...." Ky subjekt ka depozituar në QKR vetëm vendimin e rregjistrimit në vitin 2007 dhe bilacin e vitit 2007 dhe nuk ka asnjë depozitim dokumentacioni tjetër.

Nga verifikimi në sistemin e hyrje daljeve (TIMS) rezulton se shtetasi Romeo Elias nuk ka hyrë asnjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërsa shtetasja Entela Shaholli rezulton të ketë tre hyrje dalje.

Nga sa më sipër, duke marrë në konsideratë destinacionin e transfertës, lidhjen e paqartë midis përfituesit dhe dërguesit (arsyetimi me njohje në facebook), pra dërgimi tek një i panjohur që nuk e ka takuar asnjëherë i shumës 14.000 Euro ekzistojnë dyshime mbi përdorimin e tyre edhe pse burimi mund të jetë nga familjarët.

Sipas informacionit, rezultoi se me urdhrin nr.6, dt. 11.01.2016 të Drejtëorisë së Pergjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave Tirane, është vendosur bllokimi i përkohshëm i llogarisë bankare Nr.803346 në Euro pranë Raiffesien Bank të shtetases Entela Shaholli.

Në përgjigje të kërkesës së organit procedues, Raiffesinen Bnak, me shkresën me nr. 6211 prot, datë 21.01.2016 ka saktësuar faktin se shtetasja Entela Shaholli është kliente e kësaj banke dhe ka llogaritë e mëposhtme:

- Nr : 7000803346 në lekë.
- Nr. 0010803346 në euro.

Duke ju referuar sa me sipër, Prokuroria ka filluar procedimin penal nr.68 të vitit 2016 dhe është duke hetuar për veprën penale "Pastrimi i produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Faktet e mësipërme rezultojnë nga aktet shkresore të paraqitura nga Prokuroria dhe të shqyrtuara në seance gjyqësore:

- Urdher për regjistrimin e procedimit penal date 20.01.2016,
- Shkresa me nr. 145 prot, datë 19.01.2016 për dërgimin e materialit kallezues,
- Informacion për referimin e vepres penale date 20.01.2016,
- Printime nga sistemi TIMS për shtetasen Entela Shaholli,
- Urdhrin nr.6, dt.11.01.2016 i Drejtëorisë së Pergjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave Tirane
- Shkresë e Raiffeisen Bank nr.62/1 prot.date 21.01.2016 bashkangjitur dokumentacioni që i përket llogarive bankare të shtetases Entela Shaholli.

Nga sa më sipër, duke mbajtur parasysh kushtet për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestrimit preventiv të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, gjykata vlerëson se ka vend që të pranohet kërkesa për caktimin e një mase të tillë.

Neni 274 i K.Pr.Penale përcakton se:

"1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdheron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

2. Sekuestrimi mund të vendoset edhe për sendet, produktet e vepres penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.

Gjykata vlerëson se masa e sigurimit pasuror të sekuestrimit konservativ, i përgjigjet të gjitha kushteve ligjore dhe është në përputhje me rëndësinë e faktit dhe shkallën e nevojave të marrjes të një mase të tillë për rastin konkret, me qëllim për të garantuar ecurinë e mëtejshme të hetimeve, pasi :

Se pari: Konstatohet nje rrezik real per kryerjen e veprimeve apo transakcioneve te tjera nga ana e shtetases Entela Shaholli, te tilla qe krijojne dyshim te arsyeshem se disponimi i lire i llogarise bankare te poseduar prej kesaj shtetaseje mund te vijoje zgjatjen e pasojave te vepres penale objekt i ketij procedimi.

Se dyti: Vendosja e mases se sigurimit te kerkuar nga ana e prokurorise, eshte jo vetem me karakter te ngutshem, por edhe e justifikuar dhe provuar ne rrethanat konkrete te ceshtjes. Per kete mbahet parasysh koha e shkurter nga hapja e llogarise dhe dergeses qe ajo kerkon te beje nga llogaria, e pare kjo edhe ne lidhje me dyshimin per burimin e ketyre te ardhurave, si edhe destinacioni i transfertes drejt nje shtetasi te huaj me te cilin nuk eshte takuar asnje here, rrethana keto qe e bejne te besueshem dyshimin per nje veper penale konkrete ne fushen financiare.

PËR KËTO ARSYE

Ne baze te nenit 244, 245 dhe 274 te K.Pr.Penale

V E N D O S I

-Pranimin e kerkeses te Prokurorise prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce.

-Vendosjen e mases te sigurimit pasuror "sekuyster preventive" mbi llogarine bankare ne leke te shtetases Entela Hysen Shaholli prane Raiffeisen Bank sh.a., perkatesisht llogaria ne leke me nr. 7000803346, dhe llogaria ne valute me nr. 0010803346.

-Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Korce, brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes, per subjektet e interesuara afati fillon nga e nesermja e venies ne dijeni lidhur me kete vendim.

U shpall ne Korce, ne date 23.01.2016.

SEKRETARE
Hajrie RUSI



GJYQTARE
Luljeta KOLE



VERTETOHET
NJESIA E
FOTOKOPJES
ME ORJGJINALIN
KORCE ME 25.11.2020

që m'u dha me dajje

Arhiviste Marinela Analli



KANCELARE

